

ZHVILLIMI DHE UDHËHEQJA E ARSIMIT NË KOMUNËN E MALISHEV S - SFIDAT PËR TË ARDHMEN

Januz Kastrati

E-mail:kastrati.norga@hotmail.com

Abstrakt

Angazhimi i drejtpërdrejt në dhënien e kontributit në procesin edukativo-arsimor është realizimi i një pjese të obligimeve ndaj fëmijëve tanë, prandaj edhe ky process duhet të bëhet me përsosmëri dhe të ketë dinjitet. Komuna e Malisheves është njëra nga komunat më të reja të Kosovës. E ndërtuar ndërmjet luhatjeve politike serbe dhe ndjenjave nacionale shqiptare, banorët e saj kanë pësuar nga strukturat politike (kryesisht policore) të pushtetit serbë, për aq sa kanë përfituar nga përpjekjet individuale dhe kolektive shqiptare, kryesisht në fushë të arsimit dhe emancipimit të brezit të ri të shqiptarëve. Kjo komunë ka kaluar nëpër periudha të vështira. Ka qenë komuna e vetme e rasformuar në vitet e '90-ta me vendim të Kuvendit të Serbisë dhe rrjedhimisht edhe më e dëmtuara nga ky regjim edhe në luftën e fundit në Kosovë. Ka një pozitë të mire gjeografike, edhe për faktin se është në një udhëkryq që lidhë qendrat kryesore Prishtinë-Gjakovë dhe Prizren-Pejë. Nëpër teritorin e Malishevës kalon edhe autostrada “Ibrahim Rugova” që lidhet me “Rrugën e Kombit” në Shqipëri. Malisheva sipas regjistrimit të vitit 2011. ka 54664 banorë apo 3.15% e popullsinë së Kosovës (1733872). Në regjistrimin e fundit të popullsisë, për herë të parë kemi rastin e numrit më të madh të popullsisë femërore në raport me atë mashkullore (51.17% femra). Nxënësit përbëjnë 32.16% apo rreth 1/3, ndërsa ata në shkollimin e mesëm të lartë përbëjnë 6.11% të popullsisë së Malishevës. Komuna e Malishevës dallohet sidomos për bukuritë natyrore që ka. Kanioni i Mirushës dallohet jo vetëm në Kosovë por edhe më gjërë, sikur edhe Bazeni i Banjës. Dallohet poashtu edhe për bimën e quajtur lulë bozhurja, që mendohet se është endemike, sikur edhe për format relievoze karstike të brendshme, e sidomos shpellat.

Fjalët nyja: *Shkolla, sfidat, arsimi, Komuna e Malisheves, Kosova*